

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/26300-26-2068-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me karburante**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Petrol Company - SH.P.K.
NUI	810527195
Adresa	, Magjistrallja Pr-F.Kosovë
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	038/606766
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	FATOS SHALA
Adresa elektronike	fatosshala@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	13.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror[[**Lot 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)**][**Lot 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)**]

- **Njoftimi për Kontratë është publikuar më datë 20.04.2026;**
- **Përgjigjet në pyetjet e operatorëve ekonomikë janë publikuar më datë 20.05.2026;**
- **Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 11.06.2026;**
- **Hapja e ofertave është bërë më datë 11.06.2026;**
- **Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është publikuar më datë 21.07.2026.**
- **Kerkesa per Rishqyrtim 27.07.2026**
- **Vendimi i AK mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim 03.08.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja permes platformes elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, paraqesim këtë ankesë pranë

Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur më datë 27.07.2026.

- **LOT 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror;**
- **LOT 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal);**
- **LOT 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal).**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Nenin 1 i LPP – Qëllimi i Ligjit;**
- **Nenin 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
- **Nenin 7 i LPP – Barazia në Trajtim dhe Mos-Diskriminimi;**
- **Nenin 53 i LPP – Sqarimet dhe interpretimi i Dosjes së Tenderit;**
- **Nenin 56 i LPP – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;**
- **Nenin 59 i LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;**
- **Nenin 60 i LPP – Kriteret për Dhënien e Kontratës**

Neni 38 i Rregullores së prokurimit publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI NR. 1

MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS NR. 4 – GARANCIONI/AUTORIZIMI NGA RAFINERIA/PRODHUESI

Në Kërkesën për Rishqyrtim, kompania jonë ka ngritur pretendimin ankimor lidhur me

mospërmbushjen e Kërkesës nr. 4 të Dosjes së Tenderit, e cila kërkonte:

Kërkesa nr. 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."

Si evidencë për përmbushjen e kësaj kërkesë është kërkuar: ***"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria – që garanton që do të furnizojë për kontratën/Lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."***

Gjatë procedurës së prokurimit, një operator ekonomik ka kërkuar sqarim nëse do të pranohej edhe autorizimi ose konfirmimi i lëshuar nga distributori zyrtar i prodhuesit/rafinerisë. Pyetja ka qenë: ***"Ju lutem të sqaroni dhe konfirmoni nëse do të pranohet edhe autorizimi apo konfirmimi i lëshuar nga distributori zyrtar i prodhuesit/rafinerisë, i cili vepron si përfaqësues i autorizuar dhe realizon furnizimin e mallrave të kërkuara."*** Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e publikuar më datë **20.05.2026**, ka deklaruar: ***"Nuk aprovohet. Kërkohej një garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria ku furnizoheni. Nuk pranohet nga çfarëdo distributori që nuk është rafineri."*** Ky sqarim është pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të ofertave.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin (Formulari B58), kompania jonë ka realizuar qasje në ofertën e operatorit ekonomik të shpallur fitues, **IP-KOS Sh.p.k.**, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se dokumenti i dorëzuar për përmbushjen e Kërkesës nr. 4 nuk është në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe as me sqarimin zyrtar të Autoritetit Kontraktues. Dokumenti mban titullin **"Confirmation and Supply Guarantee for Tender No. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lots 1, 2, 5, 7 and 8)"**, me datë **29.05.2026**, drejtuar Agjencisë Qendrore të Prokurimit, dhe ka për lëndë **"Konfirmim dhe Garanci për Furnizim për Tenderin Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8)"**.

Data: 29 maj 2026

Për: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Lënda: Konfirmim dhe Garanci për Furnizim për Tenderin Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8)

Të nderuar,

Me këtë letër konfirmojmë se BP Oil International Limited, me seli të regjistruar në Chertsey Road, Sunbury on Thames, Middlesex, TW16 7BP, Londër, Mbretëria e Bashkuar, nëpërmjet furnizuesit të saj të autorizuar GEGA OIL S.H.A., mban një marrëdhënie aktive tregtare furnizimi me IP-KOS Sh.p.k. (Nr. i Regjistrimit të Biznesit: 810834673) për furnizimin me produkte të naftës.

Bazuar në bashkëpunimin tonë ekzistues tregtar, konfirmojmë dhe garantojmë aftësinë dhe angazhimin tonë për të siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë me produkte të naftës për IP-KOS Sh.p.k., me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të saj sipas Tenderit Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1, konkretisht për Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8, në rast

se **IP-KOS Sh.p.k.** shpallet fituese e kontratës(ave) përkatëse. Ky konfirmim lëshohet me kërkesë të **IP-KOS Sh.p.k.**, vetëm për qëllime të pjesëmarrjes në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik.

Me respekt, Për dhe në emër të BP Oil International Limited / GEGA OIL GROUP SH.A.

Në këtë dokument thuhet se “**BP Oil International Limited**, nëpërmjet furnizuesit të saj të autorizuar **GEGA OIL SH.A.**, mban një marrëdhënie aktive tregtare furnizimi me **IP-KOS Sh.p.k.**”, ndërsa më tej konfirmohet dhe garantohet furnizimi me produkte të naftës për **IP-KOS Sh.p.k.** për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve sipas tenderit. Dokumenti përfundon me formulimin: “**For and on behalf of BP Oil International Limited / GEGA OIL GROUP SH.A.**”

Nga vetë përmbajtja e dokumentit rezulton se marrëdhënia komerciale dhe furnizimi realizohen **përmes GEGA OIL SH.A.**, e cila identifikohet si “**authorized supplier**”. Pra, dokumenti nuk e paraqet marrëdhënien ndërmjet **IP-KOS Sh.p.k.** dhe **BP Oil International Limited** si një furnizim të drejtpërdrejtë, por e lidh atë përmes një furnizuesi të autorizuar. Kjo është pikërisht rrethana për të cilën Autoriteti Kontraktues, në sqarimin e datës 20.05.2026, kishte deklaruar shprehimisht se “**Nuk pranohet nga çfarëdo distributori që nuk është rafineri.**” Për rrjedhojë, pranimi i një dokumenti të tillë gjatë vlerësimit ngre çështjen nëse Autoriteti Kontraktues ka aplikuar të njëjtin standard që kishte përcaktuar në sqarimin zyrtar të tenderit.

Për më tepër, dokumenti nuk përmban elemente të mjaftueshme për të identifikuar qartë personin nënshkrues, pozitën e tij zyrtare dhe kompetencën për të vepruar në emër të **BP Oil International Limited**. Në veçanti, nuk identifikohet qartë emri dhe pozita zyrtare e personit nënshkrues, autorizimi i tij për të vepruar në emër të **BP Oil International Limited**, apo dokumenti që dëshmon kompetencën e tij për të lëshuar një garancion ose konfirmim të tillë.

Në Kërkesën për Rishqyrtim, kompania jonë ka ngritur edhe dyshime lidhur me personin e identifikuar si nënshkrues, **Brian Puffer**. Nga verifikimet e kryera në burime publike profesionale rezultonte se, nga marsi 2024, **Brian Puffer** mban pozitën **Chief Financial Officer** në **The Weir Group PLC**, ndërsa deri në shkurt 2024 kishte ushtruar pozitën **Chief Financial Officer and Chief Risk Officer for BP Integrated Supply and Trading**. Duke pasur parasysh se dokumenti mban datën **29.05.2026**, këto rrethana ngritën dyshime të arsyeshme nëse personi në fjalë kishte ende autorizim apo kompetencë për të vepruar në emër të **BP Oil International Limited** në datën e lëshimit të dokumentit. Këto dyshime nuk janë paraqitur si konstatim përfundimtar, por si çështje që kërkonte verifikim nga vetë **BP Oil International Limited**, pikërisht për shkak se dokumenti pretendohet se ishte lëshuar në emër të saj.

Qëndrimi i AQP-së në vendimin për Kërkesën për Rishqyrtim

Me datë **03.08.2026**, AQP ka refuzuar këtë pretendim, duke arsyetuar, ndër të tjera, se **“BP” është prodhues** dhe se dokumenti përmban konfirmimin e “BP”-së që mbështet drejtpërdrejt IP-KOS Sh.p.k.

Citat: Refuzohet pretendimi qe Konfirmimi nga prodhuesi nuk eshte sipas kerkeses se AK-se si dhe refuzohet pretendimi qe ky konfirmim nuk eshte ne harmoni me sqarirnin e ofruar nga AK kjo pasi qe "BP" eshte prodhues dhe ne dokumentin e dorezuar nga IP-KOS shpk, eshte konfirmimi nga "BP" qe perkrah direkt IP-KOS shpk, kete edhe po e citojme "Based on our existing commercial cooperation, we hereby confirm and guarantee our ability and commitment to ensure the continuous and uninterrupted supply of petroleum products to IP-KOS Sh.p.k for the pupose of fullfillingits obligations under Tender No.201/26300-26-2068-J-I-I, specifically for Lots 1,2,5,7 and 8, should IP-KOS Sh.p.k be awarded the respective contract(s)." Pra me kete rast nuk ka asnje dyshim qe ky konfirmim ploteson kerkesen e dosjes se tenderit dhe sqarimeve pasi qe "BP" nuk eshte distributor por eshte prodhues prej me te medhenjve ne bote. Pra ne sqarime nuk eshte lejuar qe konfirmimi te jete nga distributori por qe ne kete rast konfirmimi eshte nga "BP". Sa i perket pretendimit qe personi qe ka nenshkruar nuk eshte kompetent nga "BP" AK-AQP per hire te transparences ka derguar kete dokument edhe ne email adresen e "BP", ju njoftojme qe deri ne keto momente nuk e ka kontestuar dhe nuk ka derguar ndonje informacion per te, ndersa nga ofertuesi kemi kerkuar sqarim te cilet kane bashkangjitur nje deklarate te nenshkruar dhe vulosur me c'rast edhe mbajne pergjegjesin per vertetesine e ketij dokumenti, gjithsesi edhe ankuesi (si dhe dy Operator tjere Ekonomik) ka pasur ate dokument dhe para dergimit te kerkeses per rishqyrtim ka pasur mundesin ta konfirmoj nese eshte i falsifikuar dokumenti dhe edhe me tutje nese ka fakte te tilla besojme qe duhet te ju drejtohet organeve tjera kompetente pasi qe ne nuk mund ta verifikojme. Bazuar ne keto informacion konsiderojme qe vleresimi eshte kryer ne harmoni te plote me LPP-ne dhe pretendimet tuaja refuzohen te pabazuar.

Megjithatë, pas këtij vendimi, kompania jonë, për shkak të rëndësisë së çështjes dhe për të eliminuar çdo paqartësi lidhur me autenticitetin e dokumentit, iu drejtua drejtpërdrejt **BP Oil International Limited** më datë **04.08.2026**, duke kërkuar konfirmim lidhur me dokumentin në fjalë. Me datë **06.08.2026**, BP iu përgjigj kërkesës sonë me deklaratën: **“We can confirm that we do not recognise the letter referred to in your correspondence, and we are taking appropriate steps in response.”**

Në gjuhën shqipe, BP ka deklaruar: **“Mund të konfirmojmë se nuk e njohim letrën e referuar në korrespondencën tuaj dhe se po ndërmarrim hapat e duhur në përgjigje të kësaj çështjeje.”** Kjo përgjigje është jashtëzakonisht relevante për çështjen objekt shqyrtimi, pasi nuk kemi të bëjmë më vetëm me një dyshim të ngritur nga kompania jonë lidhur me autenticitetin ose kompetencën e nënshkruesit, por me një **konfirmim të drejtpërdrejtë nga vetë subjekti në emër të të cilit pretendohet se është lëshuar**

dokumenti, se ai nuk e njeh letrën në fjalë. Me datë **07.08.2026**, këtë përgjigje zyrtare të BP-së ia kemi përcjellë AQP-së, duke kërkuar që ajo të merret parasysh në vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës dhe të vendimit të marrë.

Një rrethanë tjetër me rëndësi të veçantë është mënyra se si vetë AQP e ka trajtuar çështjen e verifikimit të dokumentit. Nga vendimi i AQP-së rezulton se AQP, për shkak të çështjeve të ngritura lidhur me autenticitetin dhe kompetencën e nënshkruesit, i është drejtuar drejtpërdrejt BP-së për të kërkuar sqarim/verifikim të dokumentit. Në atë fazë, BP nuk kishte dhënë përgjigje. Pikërisht për këtë arsye, AQP më pas i është drejtuar **IP-KOS Sh.p.k.** dhe i ka kërkuar që të sigurojë sqarimin/konfirmimin nga BP. Kjo tregon se vetë AQP e ka konsideruar verifikimin nga BP si relevant dhe të nevojshëm për të vlerësuar autenticitetin dhe vlefshmërinë e dokumentit.

Nëse dokumenti ishte realisht i lëshuar nga BP dhe nëse IP-KOS Sh.p.k. kishte pasur komunikim real me BP lidhur me lëshimin e tij, operatori ekonomik kishte mundësi konkrete që të siguronte konfirmimin nga burimi origjinal. Megjithatë, në vend që të sigurohej një konfirmim nga BP se dokumenti ishte lëshuar dhe njihej prej saj, AQP ka pranuar një deklaratë nga IP-KOS Sh.p.k. dhe e ka konsideruar atë të mjaftueshme për të mbështetur vërtetësinë e dokumentit.

Në këtë pikë duhet të bëhet një dallim thelbësor ndërmjet mungesës së përgjigjes së BP-së dhe përgjigjes së saj të mëvonshme. Në vendimin e datës **03.08.2026**, AQP është mbështetur, ndër të tjera, në faktin se dokumenti i ishte dërguar BP-së për verifikim dhe se BP nuk e kishte kundërshtuar atë deri në atë moment. Megjithatë, pas datës **06.08.2026**, kjo gjendje faktike ka ndryshuar në mënyrë thelbësore. Tashmë nuk kemi më vetëm mungesë të përgjigjes, por kemi një përgjigje të qartë dhe eksplicite të BP-së: **“We can confirm that we do not recognise the letter referred to in your correspondence.”** Për rrjedhojë, AQP nuk mund të mbështetet më në mungesën e mëparshme të përgjigjes së BP-së si argument në favor të dokumentit, pa trajtuar faktin e ri dhe material se BP tani ka deklaruar shprehimisht se **nuk e njeh letrën**.

Në të njëjtën mënyrë, deklarata e IP-KOS Sh.p.k. se dokumenti është i rregullt nuk e zëvendëson verifikimin nga BP. Çështja nuk është vetëm nëse IP-KOS Sh.p.k. deklaroi se dokumenti është i vërtetë, por nëse dokumenti është lëshuar realisht nga **BP Oil International Limited**, nëse njihet nga BP Oil International Limited, nëse është nënshkruar nga një person i autorizuar për të vepruar në emër të BP-së dhe nëse përmbush kërkesën e detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Këto çështje lidhen drejtpërdrejt me vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur për përmbushjen e Kërkesës nr. 4.

Për më tepër, nëse IP-KOS Sh.p.k. ka pasur komunikim real me BP lidhur me këtë dokument, atëherë operatori ekonomik do të duhej të ishte në gjendje të siguronte dokumentacion ose komunikim të verifikueshëm që sqaron mospërputhjen ndërmjet dokumentit të paraqitur në ofertë dhe deklaratës së mëvonshme të BP-së. Një deklaratë e

vetë IP-KOS Sh.p.k. nuk mund të zëvendësojë konfirmimin e burimit original, veçanërisht pasi ky burim tashmë ka deklaruar se **nuk e njeh dokumentin**.

Nuk mund të pranohet as arsyetimi i AQP-së se përgjegjësia për verifikimin e dokumentit i takonte ankuesit, meqenëse ankuesi, sikurse edhe operatorët e tjerë ekonomikë, kishte pasur qasje në dokument dhe mundësi ta verifikonte nëse ai ishte i falsifikuar. Ankuesi nuk ka qenë lëshuesi i dokumentit dhe as nuk ka pasur marrëdhënie me BP në lidhje me lëshimin e tij. Dokumenti është paraqitur nga **IP-KOS Sh.p.k.** si pjesë e ofertës së saj dhe është përdorur për të dëshmuar përmbushjen e një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Prandaj, përgjegjësia për vërtetësinë dhe vlefshmërinë e dokumentit të paraqitur në ofertë nuk mund t'u transferohet operatorëve të tjerë ekonomikë.

Në këtë kontekst duhet të merret parasysh edhe dispozita e **nenit 38.7 të LPP-së**, sipas së cilës: **“Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet.”** Rëndësia e kësaj dispozite në rastin konkret qëndron në faktin se AQP i ka kërkuar IP-KOS Sh.p.k. që të sigurojë sqarimin/verifikimin e nevojshëm nga BP, pikërisht për të adresuar dyshimet lidhur me dokumentin e paraqitur. Pra, vetë AQP ka konsideruar se verifikimi nga BP ishte i nevojshëm për të përcaktuar vlefshmërinë e dokumentit. Në këto rrethana, në vend të një deklarate të vetë IP-KOS Sh.p.k., duhej të sigurohej sqarimi nga burimi original, përkatësisht nga BP.

Neni 59 i LPP-së përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit. Në rastin konkret, Kërkesa nr. 4 ka qenë kërkesë e detyrueshme. Nëse dokumenti i paraqitur për përmbushjen e kësaj kërkesë pretendohet se është lëshuar nga BP, por vetë BP më pas deklaroi se **nuk e njeh atë**, atëherë ekziston një çështje materiale lidhur me vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta konsiderojë ofertën si të përgjegjshme vetëm mbi bazën e deklaratës së operatorit ekonomik, pa trajtuar në mënyrë të arsyetuar përgjigjen e drejtpërdrejtë të subjektit që pretendohet se e ka lëshuar dokumentin.

Ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet arsytimit të AQP-së të datës **03.08.2026** dhe faktit të ri të paraqitur më **07.08.2026**. Në vendimin e datës 03.08.2026, AQP është mbështetur, ndër të tjera, në faktin se dokumenti i ishte dërguar BP-së për verifikim, se BP nuk e kishte kundërshtuar dokumentin dhe se IP-KOS Sh.p.k. kishte deklaruar se dokumenti ishte i vërtetë. Pas datës 06.08.2026, gjendja faktike është ndryshuar: BP ka dhënë përgjigje, nuk e ka konfirmuar dokumentin dhe, përkundrazi, ka deklaruar se **nuk e njeh dokumentin**. Kjo përgjigje i është përcjellë AQP-së më **07.08.2026**. Për rrjedhojë, një nga bazat faktike mbi të cilën AQP ka mbështetur arsyetimin e saj nuk mund të trajtohet më si e tillë

Përfundim

Bazuar në të gjitha rrethanat e lartcekura, konsiderojmë se çështja nuk mund të trajtohet më vetëm mbi bazën e dokumentit të paraqitur nga IP-KOS Sh.p.k. dhe deklaratës së saj për vërtetësinë e këtij dokumenti.

Kjo për shkak se:

Dosja e Tenderit kërkonte shprehimisht garancion, autorizim ose konfirmim nga rafineria/prodhuesi;

Autoriteti Kontraktues kishte sqaruar shprehimisht se nuk pranohej konfirmimi nga distributorët që nuk janë rafineri;

IP-KOS Sh.p.k. ka paraqitur një dokument që pretendohet se është lëshuar në emër të BP Oil International Limited;

AQP, për shkak të dyshimeve lidhur me dokumentin, vetë i është drejtuar BP-së për verifikim;

BP fillimisht nuk kishte dhënë përgjigje, për çka AQP i kishte kërkuar IP-KOS Sh.p.k. që të siguronte përgjigjen nga BP;

më 06.08.2026, BP është përgjigjur në emailin e kompanisë sonë dhe ka deklaruar se nuk e njeh letrën në fjalë;

këtë përgjigje ia kemi përcjellë AQP-së më 07.08.2026; me 12.08.2026 kemi pranuar email që i është dërguar shkresa direkt AQP-se dhe,

pavarësisht këtij fakti të ri, AQP nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejme për ta trajtuar në mënyrë substanciale këtë përgjigje.

Në këto rrethana, konsiderojmë se AQP ka pasur detyrimin që, pas pranimi të përgjigjes së BP-së të datës **06.08.2026**, ta rishqyrtojë përfundimin lidhur me përmbushjen e Kërkesës nr. 4 dhe të japë një arsyetim konkret se si mund të konsiderohet i vlefshëm një dokument të cilin vetë subjekti në emër të të cilit pretendohet se është lëshuar deklaron se **nuk e njeh**. Pranimi i kësaj përgjigjeje dhe mosadresimi i saj nuk mund të konsiderohet çështje formale, pasi ajo prek drejtpërdrejt **autenticitetin, burimin dhe vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur për përmbushjen e një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.**

Në përfundim, konsiderojmë se pranimi i ofertës së IP-KOS Sh.p.k. si ofertë e përgjegjshme, pa trajtuar dhe pa dhënë arsyetim të bazuar mbi përgjigjen e drejtpërdrejtë të BP-së, përbën cenim të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe të dispozitave të LPP-së që rregullojnë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Shkelja e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik

Veprimi i Autoritetit Kontraktues për pranimin dhe vlerësimin si të përgjegjshme të ofertës së operatorit ekonomik **IP-KOS Sh.p.k.**, përkundër faktit se ky operator ekonomik nuk ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës nr. 4 të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përbën shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka shkelur

nenin 1 të LPP-së – Qëllimi i Ligjit, pasi nuk ka siguruar zhvillimin e një procedure të drejtë, transparente dhe konkurruese;

nenin 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pasi nuk ka garantuar përzgjedhjen e një operatori ekonomik që plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara;

nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim dhe Mos-Diskriminimi, pasi ka aplikuar standarde të ndryshme në interpretimin dhe zbatimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke krijuar avantazh të padrejtë për operatorin ekonomik të shpërblyer me kontratë;

nenin 53 të LPP-së – Sqarimet, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar interpretimin zyrtar të dhënë përmes sqarimit të publikuar, ku kishte përcaktuar qartë se dokumentet e lëshuara nga distributorët që nuk janë rafineri nuk do të pranoheshin;

nenin 56 të LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, pasi kontrata është dhënë për një operator ekonomik që nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në Dosjen e Tenderit;

nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pasi Autoriteti Kontraktues ka pranuar një ofertë që nuk është në përputhje me kërkesat teknike dhe profesionale të tenderit;

nenin 60 të LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës, pasi kontrata është dhënë duke mos u bazuar në një ofertë të përgjegjshme dhe të pajtueshme me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit; di dhe

nenin 38.6 të Rregullores së prokurimit publik, pasi që nuk ka pranuar përgjigjen në kërkesën për sqarim

Për këtë arsye, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të konstatohet se oferta e **IP-KOS Sh.p.k.** nuk ka dëshmuar në mënyrë të vlefshme përmbushjen e Kërkesës nr. 4, ose së

paku që AQP të detyrohet ta trajtojë në mënyrë të plotë, konkrete dhe të arsyetuar përgjigjen zyrtare të **BP Oil International Limited** të datës **06.08.2026**. Pranimi i ofertës së IP-KOS Sh.p.k. si ofertë e përgjegjshme, pa trajtuar dhe pa dhënë arsyetim të bazuar mbi përgjigjen e drejtpërdrejtë të BP-së, përbën cenim të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe të dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke shpallur fitues OE i cili nuk plotëson kriteret e percaktuara nga vet AK, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- 1. Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;**
- 2. Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;**
- 3. Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.**

Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga OSHP që:

- 1. Të aprovoje ankesën tone si të bazuar;**
- 2. Te anulojë Njoftimin mbi Vendimin e datës 27.07.2026 për Lotet 2, 5 dhe 7;**
- 3. Të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe Ligjin për Prokurimin Publik;**
- 4. Gjatë ri-vlerësimit të shpallë ofertën tonë fituese pasi që kemi dorëzuar ofertën e përgjegjshme me cmimin me të ulet.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrë të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*